

C.A.U.S.E. – Përdorimi i Pronave të Konfiskuara për Sipërmarrje Sociale është iniciativa e parë e kësaj natyre e zbatuar në Shqipëri dhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor, që synon të krijojë një model të ri-përdorimit të qendrueshëm të aseteve të konfiskuara nga krimi i organizuar, nga organizatat e shoqërisë civile. C.A.U.S.E. zbatohet nga Partnerët Shqipëri, në partneritet me Project Ahead dhe Comitato Don Peppi Diana, dhe në bashkëpunim me Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara. Projekti financohet nga Bashkimi Evropian.

Buxheti total: 89,717.250 Euro

Kontributi i BE: 85,231.37 Euro (95%)

Periudha e zbatimit: 3 maj 2019 - 2 maj 2020

Organizata zbatuese: Fondacioni Arsimor Shqiptar në partneritet me Qendrën për Zhvillimin e Shoqërisë Civile Durrës

KIN FOLK COFFEE
LIBRARY DURRES

KinFolk Coffee Library

Rezultate gjatë
vitit të parë
të zbatimit

KinFolk Coffee Library është një iniciativë e ngritur në një pronë të konfiskuar nga krimi i organizuar në Durrës, duke e transformuar atë në një mjedis miqësor për të rinjtë, veçanërisht ata që janë në rrezik ndaj kriminalitetit të të miturve, familjet e tyre dhe qytetarët. Duke i angazhuar ata në nisma sociale, kulturore dhe edukuese, Kinfolk shërben si një masë parandaluese ndaj përfshirjes së të rinjve në aktivitete kriminale.

Kinfolk Coffee Library është një qendër multifunkionale ku të rinjtë mund të takohen, të përfitojnë nga një gamë e gjerë trajnimesh, kursesh mësimore dhe aktiviteteve socio-kulturore dhe të kalojnë kohën e lirë. Kinfolk shërben si një vend për punësim, ri-integrim dhe pasurim të jetës shoqërore të të rinjve, pjesë e shërbimit të provës. Kinfolk Coffee Library është e hapur për të gjitha organizatat, shkollat, dhe institucionet që të zhvillojnë aktivitetet e tyre në këtë mjedis.

- ✓ Një mjedis i përshtatshëm ku të rinjtë mund të mësojnë, punojnë dhe ndërveprojnë;
- ✓ **4 të rinj nga grupe të marginalizuara** të punësuar;
- ✓ Mbi **150 të rinj & studentë** janë angazhuar në aktivitete edukuese, artistike dhe kulturore;
- ✓ **7 programe trajnimi** për studentët për rritjen e aftësive të tyre drejtuese, advokasi dhe lobim, sipërmarrjet sociale, pjesëmarrja në qeverisjen qendrore dhe vendore, përgatitja për punë, etj.;
- ✓ **27 programe kursesh** në gjuhë të huaja dhe shkenca ekzakte për të rinjtë;
- ✓ **Shkollë verore dhe dimërore** për studentët e shkollave të mesme;
- ✓ Organizimi i **1 panairi pune** duke sjellë së bashku bizneset lokale dhe të rinjtë të cilët janë në kërkim të punës.

